

THIRRJE PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR POZICIONET E ANËTARËVE TË INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQATARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Avokati i Popullit, bazuar në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpall vendet vakante për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **Anëtar i Komisionit dhe/ose Gjyqtar i Kolegjit të Apelit, si dhe Komisionerit Publik.**

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 09/02/ 2017 (afati 15 ditë) në një nga format e dhëna më poshtë:

- **Paraqitjes së aplikantëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 2, Tiranë zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte; ora: 08:30-16:30.** Në këtë rast, kandidati regjistrohet në regjistrin e protokollit të Avokatit të Popullit si dhe pajiset me një dokument që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.
- **Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 2, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 09/02/ 2017 (afati 15 ditë), i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Avokatit të Popullit konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- **Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: reformanedrejtisi@avokatipopullit.gov.al** Institucioni i Avokatit të Popullit konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se kandidati nuk ka përcaktuar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 2 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) jetëshkrim profesional, (kandidatët aplikantë inkurajohen që krahas versionit shqip, i cili është i detyrueshëm, **ta paraqesin këtë dokument edhe në gjuhën angleze**) përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) kopje të noterizuara ose të njësuar të diplomës nga organi përkatës;

c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuar nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

ç) një dokument të nënshkruar prej tij, me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në komunikimet elektronike gjatë kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve të rivlerësimit, sipas Shtojcës 1 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument mund të shkarkohet në këtë link <http://www.avokatipopullit.gov.al/vetingu>

Në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, emrat e kandidatëve aplikues që kanë shprehur interesin për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, do të bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit: www.avokatipopullit.gov.al

Për më shumë informacion në lidhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin e sipërcituar, lutemi klikoni në adresën:

<http://www.avokatipopullit.gov.al/vetingu>